




Oral-B



Pampers

P&G



# Të gjitha markat, një praktikë për t'ju mbrojtur.



## Të dhënat që na jepni.

Mbledhim informacion që na jepni përmes përvojës së mar ose jo në internet si dhe informacion që u keni dhënë kompa japin ato të dhëna. Mund të kontrolloni të dhënat tuaja



## PRAKTIKA E KONFIDENCIALITETIT

Azhornuar më 18 mars, 2024

[Shkarkoni një kopje të kësaj Praktike të konfidencialitetit \(PDF\).](#)

### Pyetjet e shpeshta

Pyetjet e bëra zakonisht në lidhje me mënyrën sesi mbledhim, ruajmë dhe përdorim të dhënat tuaja personale, siç përcaktohet në ligjet në fuqi.

A i shesim të dhënat tuaja personale për kompensim monetar?

Jo

A ua zbulojmë të dhënat tuaja personale partnerëve të palëve të treta?

[Po, atje ku kemi një bazë të ligjshme për ta bërë këtë.](#)

A marrim të dhëna personale nga kompani të tjera të cilave u keni dhënë leje?

[Po](#)

A i përdorim të dhënat tuaja personale për rekomandime më të mira të produkteve dhe përvoja të faqes në internet?

[Po, atje ku kemi një bazë të ligjshme për ta bërë këtë.](#)

A jua japim kontrollin e të dhënave tuaja personale?

[Po](#)

---

## Si i kontrolloni të dhënat tuaja personale

**Jeni në kontroll të të dhënave tuaja personale. Mund t'i ushtroni të drejtat tuaja dhe t'i ndryshoni preferencat tuaja në çdo kohë.**

### ✓ Kërkesa për të drejtat si subjekt i të dhënave

Në varësi të vendndodhjes suaj (juridiksionit në të cilin jeni banor), mund të keni të drejta të ndryshme që ju vihen në dispozicion si subjekt të dhënash. Këto mund të përfshijnë kërkesa për akses, fshirje, korigjim/ndreqje, për t'u çregjistruar nga marrja e emaileve ose teksteve të marketingut, kundërshtim ndaj përdorimit nga ana jonë të adresës tuaj të emailit ose numrit të telefonit për reklama, etj. Për të paraqitur një kërkesë për të Drejtat si subjekt i të dhënave për juridiksionin tuaj, klikoni [këtu](#).

Gjithashtu mund të na thoni të ndalojmë se dërguari email dhe mesazhe me tekst juve duke ndjekur udhëzimet e largimit të dërguara me këto komunikime. Ju lutemi jini të vetëdijshëm se mund të na duhet të mbajmë njëfarë informacioni për të respektuar zgjidhjet tuaja (p.sh. nëse na thoni të ndalojmë së dërguari email-a të marketingut, do të na duhet adresa juaj e email-it në skedar në mënyrë që sistemet tona të mbajnë mend se nuk dëshironi të merrni më komunikime të marketingut në atë adresë të e-mail-it).

Gjithashtu, ekzistojnë disa situata ku mund të mos jemi në gjendje të plotësojmë kërkesën tuaj (p.sh. fshirja e të dhënave të veprimit ku kemi një detyrim ligjor për ta mbajtur atë ose për parandalim të mashtrimit, sigurisë ose për të mbrojtur konfidencialitetin e të tjerëve, mes gjërave të tjera).

### ✓ Reklamimi tradicional në bazë të sjelljes në internet

## ▼ Si e ushtroni zgjedhjen për reklamat me bazë interesi

### Çregjistrimet e industrisë së reklamimit

Për SH.B.A.-në, për të ushtruar zgjedhje në lidhje me reklamat me bazë interesi, mund të përdorni mekanizmin e çregjistrimit të ofruar nga Alenca dixhitale e reklamimit ("DAA") [duke klikuar këtu](#) (për shfletuesit) ose [këtu](#) (për mospjesëmarrje bazuar në aplikacione).

Iniciativa e reklamimit në rrjet ("NAI") ka zhvilluar një mjet që u lejon konsumatorëve të çregjistrohen nga Reklama të caktuara me bazë interesi të ofruara nga rrjetet e reklamave të anëtarëve të NAI-t. Për të mësuar më shumë rreth mospjesëmarrjes në reklama të tilla të profilizuara ose për të përdorur funksionin NAI, shihni <http://www.networkadvertising.org/choices/>.

Për Europën, mund të klikoni [këtu](#) për të mësuar më shumë rreth programit të çregjistrimit nga DAA-Europe.

Për Kanadanë, mund të klikoni [këtu](#) për të mësuar më shumë rreth programit të çregjistrimit nga DAA Canada.

Për t'u çregjistruar nga Unified ID 2.0 në rang bote, [klikoni këtu](#).

Kini parasysh se, edhe nëse çregjistroheni nga disa lloje reklamash me bazë interesi, mund të vazhdoni të merrni reklama të tjera. Për më tej, çregjistrimi nga një ose më shumë pjesëtarë të NAI-t ose DAA-së do të thotë vetëm se këta pjesëtarë të zgjedhur nuk duhet më, sipas rregullave të DAA-së / NAI-t, t'ju ofrojnë reklama të caktuara të profilizuara. Kjo do të ndikojë në shërbimet e ofruara nga pjesëtarët përkatës të DAA-së / NAI-t, por nuk do të thotë se nuk do të merrni më asnjë përmbajtje të profilizuar dhe/apo reklama nga palë jo-pjesëmarrëse. Gjithashtu, nëse shfletuesit tuaj janë konfiguruar të refuzojnë skedarët e personalizimit kur vizitoni faqen e çregjistrimit ose më pas i fshini skedarët tuaj të profilizimit, përdorni një Pajisje ose shfletues(a) të ndryshëm interneti ose përdorni një metodë aksesimi jo të bazuar në shfletues, çregjistrimi me bazë shfletuesi nga DAA / NAI mund të mos jetë më efikas. Çregjistrimet e pajisjeve portative nuk ndikojnë në reklamat me bazë interesi nga shfletuesi edhe në të njëjtën pajisje dhe duhet të çregjistroheni veçmas për secilën pajisje. Nuk jemi përgjegjës për efikasitetin apo pajtueshmërinë me opsionet apo programet e çregjistrimit të palëve të treta apo saktësinë e deklaratave të tyre në lidhje me programet e tyre.

Gjithashtu mund të parandaloni ose pakësoni marrjen e reklamave bazuar tek interesi në faqe në internet duke refuzuar skedarët e personalizimit në

shfletuesin(it) tuaj ose në pajisjet celulare duke refuzuar kërkesat për “aksesin e të dhënave” që aplikacionet zakonisht paraqesin kur i instaloni ata ose duke rregulluar cilësimet e gjurmimit të reklamave në pajisjen tuaj.

Vini re se mund të merrni gjithashtu reklama të personalizuar bazuar në adresën tuaj të emailit ose numrin e telefonit, nëse na i keni dhënë për qëllime marketingu. Për t'u çregjistruar nga ky përdorim, ju lutemi [na kontaktoni](#).

Do të shihni ende reklama “të kontekstit” edhe nëse çregjistroheni nga reklammat me bazë interesi. Edhe nëse ndalojmë së dërguari reklama me bazë interesi, përsëri do të merrni reklama nga markat tona në kompjuter ose pajisjet tuaja portative. Këto reklama, megjithatë, janë të bazuara në kontekstin e faqeve që vizitoni dhe quhen reklama të kontekstit. Ndryshe nga reklammat me bazë interesi, të cilat bazohen në faqet që vizitoni në celular ose aktivitetet e shikimit të kompjuterit me kalimin e kohës dhe nëpër shërbime të palidhura me njëri-tjetrin, reklammat të kontekstit janë reklama që ju shfaqen bazuar në kontekstin e faqes specifike të internetit që po vizitoni. Për shembull, akoma mund të shihni një reklamë për një nga markat tona të kujdesit për foshnjën ndërsa shihni produkte të dhomës së fëmijëve në internet sepse këto faqe tradicionalisht kanë patur kryesisht prindër të rinj ose të ardhshëm si vizitorë. Duhet të dini gjithashtu se mund të mbledhim ende informacion nga kompjuteri ose pajisjet tuaja dhe ta përdorim për qëllime të tjera, si vlerësimi i mënyrës se si funksionojnë faqet tona të internetit, për kërkimin e konsumatorëve ose zbulimin e mashtrimit, në përputhje me ligjet në fuqi.

#### ✓ **Si mund të kontrolloni skedarët e personalizimit**

Mund të konfiguroni shfletuesin tuaj që të refuzojë të gjitha cookies ose të tregojë se kur një cookie po dërgohet tek kompjuteri juaj. Megjithatë, kjo mund të parandalojë faqet ose shërbimet tona që të funksionojnë siç duhet. Gjithashtu mund të konfiguroni shfletuesin tuaj që të fshijë cookies çdo herë që mbaroni shfletimin.

Kur çregjistroheni nga reklammat me bazë interesi, një skedar personalizimi i çregjistrimit dërgohet në shfletuesin tuaj që tregon se nuk dëshironi të merrni më reklama me bazë interesi. Skedari i personalizimit i çregjistrimit do të fshihet nëse vendosni të fshini të gjithë skedarët e personalizimit në shfletuesin tuaj. Kjo do të thotë se do t'ju duhet të çregjistroheni sërish nga çdo shfletues ku keni fshirë skedarët e personalizimit nëse ende nuk dëshironi të merrni reklama me bazë interesi.

Në disa tregje dhe në disa nga faqet tona të internetit, ofrojmë një platformë të menaxhimit të pëlqimit të skedarëve të personalizimit, e cila ju lejon të bëni zgjedhjen në lidhje me disa kategori të skedarëve të personalizimit. Nëse kjo është e disponueshme, mund të shfaqet si një shirit për skedarët e personalizimit dhe/ose si një ikonë që është e dukshme në faqet përkatëse të internetit. Mund të ofrojmë gjithashtu teknologji të ngjashme në aplikacionet celulare, të cilat, nëse janë të disponueshme, do të jenë të aksesueshme përmes menysë së cilësimeve të aplikacionit përkatës.

#### ✓ **Ligjet shtetërore të SH.B.A.-së për konfidencialitetin**

Shihni "[Njoftimin shtetëror të SH.B.A.-së për konfidencialitetin](#)" më poshtë për informacionin e kërkuar nga ligjet e disa shteteve për konfidencialitetin dhe informacionin në lidhje me të drejtat e konfidencialitetit sipas ligjeve të tilla.

#### ✓ **Informacion shtesë për banorët e ZEE-së, Zvicrës dhe Mbretërisë së Bashkuar**

Nëse banoni në ZEE, Zvicër ose Mbretërinë e bashkuar ose ndodheni fizikisht në ZEE, Zvicër ose MB, mund të përdorni të dhënat personale që mbajmë për ju, të kërkonti që informacioni i pasaktë, i vjetruar ose jo më i nevojshëm të korrigjohet, fshihet ose kufizohet dhe mund të na kërkonti që t'i ofrojmë të dhënat tuaja në një format që ju lejon t'i transferoni te një ofrues tjetër shërbimi. Gjithashtu mund të tërhiqni pëlqimin tuaj në çdo kohë atje ku jemi duke u mbështetur në pëlqimin tuaj për përpunimin e të dhënave tuaja personale. Dhe mund ta kundërshtoni përpunimin tonë të të dhënave tuaja personale (kjo do të thotë të na kërkonti të ndalojmë përdorimin e tyre) kur ky përpunim bazohet në interesin tonë legjitim (kjo do të thotë se kemi një arsye legjitime për përdorimin e të dhënave për një qëllim të caktuar dhe kjo arsye është nuk tejkalohet nga interesi juaj për mospërdorim nga ana e P&G). Për të bërë një kërkesë, [klikoni këtu](#).

Nëse dëshironi më shumë informacion rreth mbrojtjes së të dhënave dhe të drejtave tuaja personale në përgjithësi, vizitoni faqen e Mbikëqyrësit Europian për mbrojtjen e të dhënave në <https://edps.europa.eu/data-protection/> ose faqen e Zyrës së komisionerit të Mbretërisë së Bashkuar për Informacion <https://ico.org.uk>. Nëse nuk jeni të kënaqur me përgjigjen tonë ndaj kërkesave tuaja, mund të bëni një ankesa pranë autoritetit të mbrojtjes së të dhënave në vendin tuaj.

Procter and Gamble España SA i përmbahet Kodit të sjelljes për mbrojtjen e të dhënave në AUTOCONTROL, i akredituar nga Agjencia spanjolle e mbrojtjes së të dhënave dhe për këtë arsye i nënshtrohet sistemit të saj jashtëgjyqësor të ankesave për

përpunimin e të dhënave kur lidhet me mbrojtjen e të dhënave dhe reklamat, i disponueshëm për të interesuarit në faqen në internet [www.autocontrol.es](http://www.autocontrol.es).

#### ✓ **Profesionistë dentarë**

Nëse jeni profesionist i sektorit dentar dhe na keni dhënë të dhënat tuaja personale si pjesë e një prej programeve tona të kontaktit profesional, duke përfshirë përmes <https://www.dentalcare.com>, na kontaktoni përmes përfaqësuesit tuaj vendor të P&G, p.sh. Oral-B.

#### ✓ **Profesionistë shëndetësorë**

Nëse jeni një profesionist i sektorit shëndetësor dhe na keni dhënë të dhënat tuaja personale si pjesë e një prej programeve tona të kontaktit profesional ose ndonjë forme tjetër bashkëpunimi, na kontaktoni përmes përfaqësuesit tuaj vendor ose rajonal të P&G.

#### ✓ **Pjesëmarrësi të studimit të konsumatorëve**

Për të bërë një kërkesë lidhur me të dhënat personale që mund të kemi si pjesë e pjesëmarrjes tuaj në një nga studimet tona kërkimore, ju lutemi shihni informacionin e kontaktit të dhënë në formularin tuaj të pëlqimit ose telefononi ose vizitoni qendrën tuaja kërkimore.

---

## **Si i mbledhim dhe përdorim të dhënat personale**

**Ashtu si shumica e markave, mbledhim të dhëna personale ndërsa ndërveproni me ne ose kur jepni të dhëna personale me palët e treta që nga ana tjetër mund të na jepen. E bëjmë këtë me respekt dhe kujdes për të mbrojtur të drejtat tuaja. Të dhënat personale mund të na ndihmojnë të kuptojmë më mirë interesat dhe preferencat tuaja si konsumator dhe person.**

#### ✓ **Si i mbledhim të dhënat personale**

Mbledhim të dhëna personale për ju në shumë mënyra dhe nga shumë vende. Disa nga të dhënat personale që mbledhim mund të përfshijnë të dhëna personale që mund të përdoren për t'ju identifikuar; për shembull, emri, adresa e emailit, numri i telefonit ose adresa postare. Në disa juridiksione, gjëra si p.sh. adresa IP ose identifikuesit e skedarëve të personalizimit dhe pajisjeve portative mund të konsiderohen gjithashtu të dhëna personale.

## ✓ Na e jepni direkt

Na jepni informacionin tuaj ku regjistrohemi për një llogari në faqet tona në internet ose aplikacionet celulare ose duke na telefonuar ose dërguar email. Mund të kërkojmë për gjëra si emri juaj, adresa e email-it ose e shtëpisë, datëlindja, informacioni i pagesës, mosha juaj, gjinia, numri i personave në familjen tuaj dhe mënyra sesi dëshironi që t'ju dërgojmë informacion mbi produktet dhe shërbimet tona—për shembull, në adresën e shtëpisë tuaj, adresën e email-it ose duke ju dërguar tekst.

## ✓ Ndërveproni me faqet në internet & email-a

Mund të përdorim teknologji që automatikisht mbledhin informacion kur vizitoni faqet tona, shihni reklamën tona ose përdorni produktet ose shërbimet tona. Për shembull, përdorim cookies (një skedar i vogël i vendosur në shfletuesin e kompjuterit tuaj) për të na treguar se çfarë shfletues dhe sistem të përdorimit jeni duke përdorur, adresën tuaj të IP-së, faqet në internet që vizitoni, lidhjet që klikoni ose nëse keni hapur ose nuk keni hapur një email nga ne.

## ✓ Përdorni aplikacione të celularit & pajisje të tjera

Për t'u dhënë përvojën më të mirë të mundshme të përdoruesit, mund të përdorim teknologji që mbledhin informacion nga telefoni juaj kur përdorni aplikacionin tonë të celularit ose pajisjet tona "inteligjente" në shtëpinë tuaj. E pranoni këtë kur shkarkoni aplikacionin ose instaloni pajisje shtëpiake të lidhura me internetin. Ky informacion mund ta përfshijë ID e reklamimit të telefonit tuaj celular ose pajisjes tjetër, informacione për sistemin e përdorimit të telefonit tuaj, mënyrën se si e përdorni aplikacionin ose pajisjen, vendndodhjen tuaj fizike dhe informacione të tjera që konsiderohen të dhëna personale në disa juridiksione. Do të merrni një njoftim në telefonin ose pajisjen tuaj që ju jep mundësinë të pranoni ose refuzoni, duke na lejuar të dimë vendndodhjen tuaj të saktë (pikërisht ku jeni duke qëndruar ose nga ku jeni duke hyrë në internet) ose për të mbledhur ose aksesuar të dhëna të tjera personale, siç kërkohet nga ligjet në fuqi.

## ✓ Lidhemi me partnerë ose palë të treta

Mund të marrim informacion që kompani të treta na japin ose na shesin. Për shembull, mund të keni dhënë pëlqimin që një kompani tjetër të na japë të dhënat tuaja personale kur jeni regjistruar për shërbimet e telekomunikacionit ose një program të pikëve të besnikërisë të një dyqani. Aty ku është e mundur, mund të mbledhim gjithashtu të dhëna personale nga burime të disponueshme publikisht, si p.sh. nga postimet në internet, shkrime në blog, videot ose faqet e rrjeteve sociale. Gjithashtu mund të marrim të dhëna personale nga kompani të tjera, si p.sh. rishitësit e të

dhënave të konsumatorëve, të cilët janë në biznesin e mbledhjes ose të grumbullimit të informacionit rreth jush me burim nga bazat e të dhënave të disponueshme publikisht (në përputhje me kërkesat ligjore vendore sipas zbatimit) ose nga pëlqimi që keni dhënë për përdorimin e tyre dhe më pas përdorimin tonë të të dhënave tuaja personale. Kjo mund të përfshijë informacion për nivelin tuaj të të ardhurave, moshën, gjininë, numrin e njerëzve në familjen tuaj dhe produktet që keni blerë në internet ose nga dyqanet në lagjen tuaj.

## ✓ Mënyrat e përgjithshme të përdorimit të të dhënave personale

Përdorim të dhënave tuaja personale për të na ndihmuar të përmbushim qëllimin tonë për të prekur dhe përmirësuar jetën e njerëzve si ju çdo ditë në mbarë botën. Për shembull, përdorim informacionin tuaj për qëllimet e mëposhtme të përpunimit:

- [Produktet/shërbimet](#). Kjo përfshin kryerjen e shërbimeve për ju dhe dërgimin e produkteve ose të mostrave që keni kërkuar.
- [Menaxhimi i klientit](#). Ky përfshin:
  - Identifikimin dhe verifikimin në programet dhe faqet tona të ndryshme të marketingut
  - Administrimin dhe mbajtjen e llogarive dhe të preferencave, si dhe stimujt financiarë, shpërblimet, uljet (p.sh. kuponët e çmimeve ose të shërbimeve) dhe programet e besnikërisë (së bashku, "Programet e shpërblimeve")
  - Ndihmën që të menaxhoni preferencat e faqes së internetit ose aplikacionit P&G
  - Lejimin që të merrni pjesë në konkurset ose llotaritë dhe të lini vlerësime dhe komente
- [Shërbimi/komunikimet e klientit](#), si p.sh.:
  - Përgjigjen ndaj pyetjeve ose kërkesave tuaja për informacion
  - Ofrimin e shërbimit të klientit
  - Dërgimin e mesazheve transaksionale (si p.sh. deklaratat e llogarisë ose konfirmimet)
  - Ndërveprimin me ju në rrjete sociale
  - Dërgimin e komunikimeve të marketingut në lidhje me produktet ose shërbimet tona (ose produktet ose shërbimet e partnerëve tanë), anketat dhe ftesat



- [Pagesat/financiare](#), si p.sh.:
  - Përpunimin e pagesës suaj për produktet që blini nga ne
  - Përpunimin dhe lëshimin e rimbursimeve dhe të arkëtimeve
- [Paraqitjen e reklamave](#), Kjo përfshin paraqitjen ndaj jush të reklamave përkatëse dhe shërbimin ndaj të tjerëve, të cilët, duke pasur një profil si juaji, mund të jenë të interesuar të dëgjojnë nga ne, me reklama përkatëse përmes audiencave të personalizuarra dhe audiencave të ngjashme. Për shembull, mund të ngarkojmë adresën tuaj të shifruar të emailit në një shërbim të rrjeteve sociale dhe t'i kërkojmë atij shërbimi të rrjeteve sociale t'ju dërgojë reklamat tona juve dhe njerëzve që kanë interesa të ngjashme si ju, duke përfshirë në vende të tjera, bazuar në të dhënat që ka për ju dhe në lidhje me njerëzit e tjerë
- [Administrimin e reklamave](#), si p.sh. matja dhe gjurmimi i efikasitetit të fushatave reklamuese dhe kryerja e aktiviteteve të tjera administrative dhe kontabël në lidhje me fushatat reklamuese
- [Cilësinë dhe sigurinë](#), duke përfshirë:
  - Kontroll të cilësisë, trajnim dhe analiza
  - Mirëmbajtje dhe verifikim të sigurisë
  - Administrim të sistemit dhe menaxhim i teknologjisë, përfshirë optimizimin e faqeve tona në internet dhe aplikacioneve tona
- [Sigurinë](#), duke përfshirë zbulimin e kërcënimeve dhe mbrojtjen kundër aktiviteteve me qëllim të keq ose mashtrues
- [Arkivimin dhe auditimin](#), duke përfshirë arkivimin dhe auditimin e ndërveprimeve me konsumatorët, duke përfshirë regjistrat dhe të dhënat e mbajtura si pjesë e informacionit të transaksionit
- [Ligjore/pajtueshmërinë](#), duke përfshirë menaxhimin e rrezikut, auditimin, hetimet, raportimin dhe arsye të tjera ligjore dhe të pajtueshmërisë.
- [Kërkim-zhvillimin \("R&D"\)](#), si p.sh.
  - Kërkimet e brendshme
  - Për të dizenuar dhe zhvilluar produkte, shërbime e programe që kënaqin konsumatorët tanë

- **Qëllimet që zbulohen gjatë mbledhjes** kur jepni të dhënat tuaja personale
- **Qëllime legjitime biznesi** që janë në përputhje me qëllimin e mbledhjes së të dhënave tuaja personale dhe që nuk janë të ndaluara me ligj

#### ✓ Si i përdorim skedarët e personalizimit

Cookies janë skedarë të vegjël të dërguar tek kompjuteri juaj ndërsa lundroni në internet. Ata ruajnë informacion të dobishëm rreth asaj sesi ndërveproni me faqet në internet që vizitoni. Mund të mësoni më shumë rreth mënyrës së kontrollit të skedarëve të personalizimit [këtu](#).

I përdorim skedarët e personalizimit në disa mënyra, si p.sh.:

- për t'ju lejuar të shfletoni faqen e internetit dhe të përdorni veçoritë e saj
- për t'ju paraqitur reklamat përkatëse dhe për të matur efikasitetin e një reklame të tillë
- për t'u siguruar që nuk ju shfaqet një reklamë më shumë seç duhet (i quajtur "kufizim shpeshtësie")
- për të mësuar më shumë mbi mënyrën sesi ndërveproni me përmbajtjen P&G
- për të na ndihmuar të përmirësojmë përvojën tuaj kur vizitoni faqet tona të internetit
- për të mbajtur mend preferencat tuaja, si një gjuhë ose një rajon, në mënyrë që të mos ketë asnjë nevojë që të personalizoni faqen në internet për secilën vizitë
- për të identifikuar gabime dhe për t'i korrigjuar ato
- për të analizuar sesi janë duke funksionuar faqet tona në internet

#### ✓ Llojet e skedarëve të personalizimit që përdorim

**Skedarët e personalizimit rreptësisht të nevojshëm:** Këta skedarë personalizimi (të përmendur ndonjëherë edhe si "thelbësorë") lejojnë që faqja të ngarkojë ose të sigurojë disa funksione thelbësore pa të cilat nuk do të funksiononte (d.m.th. ruajtjen e të dhënave tuaja në kosh blerjesh).

**Skedarët e personalizimit funksionalë:** Këta skedarë personalizimi lejojnë faqet që të mbajnë mend atë që preferoni kur të ktheheni përsëri. Për shembull, nëse zgjidhni ta lexoni faqen në frëngjisht në vizitën tuaj të parë, herën tjetër që ktheheni përsëri, faqja do të shfaqet automatikisht në frëngjisht. Duke mos patur nevojë për të zgjedhur një

preferencë të gjuhës çdo herë e bën më të volitshme, me të efektshme dhe më miqësore për t'u përdorur për ju.

**Skedarët e personalizimit të reklamimit:** Këta skedarë personalizimi mund të përdoren për të mësuar se çfarë interesash mund të keni në përgjithësi, bazuar, për shembull, në faqet e internetit që vizitoni dhe produktet që blini. Ato të dhëna na lejojnë t'ju dërgojmë të dhëna për produkte dhe shërbime që u përshtaten më mirë gjërave që ju pëlqejnë ose që ju nevojiten. Gjithashtu na lejojnë të kufizojmë numrin e herëve që shihni të njëjtën reklamë.

**Skedarët e personalizimit statistikorë:** Këta skedarë personalizimi na tregojnë se si i përdorni faqet tona të internetit, si cilat faqe keni vizituar dhe cilat lidhje keni klikuar. Kjo na ndihmon të masim dhe përmirësojmë rendimentin e faqeve tona të internetit. Përdorim skedarë të ndryshëm personalizimi statistikorë në juridiksione të ndryshme. Në shumë raste, përdorim skedarët e Google Analytics për të monitoruar rendimentin e faqeve tona. Aftësia jonë për të përdorur dhe ndarë informacionin e mbledhur nga Google Analytics në lidhje me vizitat tuaja në faqet tona është i kufizuar nga [Kushtet e përdorimit të Google Analytics](#) dhe [Politika e konfidencialitetit e Google](#).

**Skedarët e personalizimit të rrjeteve sociale:** Këta skedarë personalizimi, të vendosur nga një sërë shërbimesh të rrjeteve sociale që kemi shtuar në faqe, ju lejojnë të ndani përmbajtjen tonë me miqtë dhe rrjetet tuaja dhe na mundësojnë t'ju arrijmë me reklama në ato platforma sociale që lidhen me vizitat tuaja në faqet tona. Skedarët e personalizimit e disa faqeve të rrjeteve sociale, p.sh., Facebook, përdoren gjithashtu për profilizimin e reklamave.

## ✓ Reklamimi me bazë interesi

Kur vizitoni faqet tona partnere, mund t'ju tregojmë reklama ose përmbajtje tjetër që besojmë se do t'ju pëlqejë të shihni. Për shembull, mund të merrni reklama për detergjentin e larjes së rrobave Tide® nëse vëmë re se jeni duke vizituar faqe që shesin rroba për fëmijë ose pajisje shkollore. Nga ai informacion mund të arrijmë në përfundimin se keni fëmijë dhe prandaj mund të jeni të interesuar në një produkt të fuqishëm për pastrimin e rrobave. Në këtë mënyrë synojmë t'ju dërgojmë informacion të përshtatshëm për produktet tona që mund t'ju sjellë përfitime. Për të mësuar më shumë rreth zgjedhjeve tuaja në lidhje me reklamat me bazë interesi, shkoni [këtu](#).

**Mësojmë nga grupet e konsumatorëve që ndajnë interesa të ngjashme:** Mund t'ju vendosim në një grup të caktuar konsumatorësh që shfaqin të njëjtat interesa. Për shembull, mund t'ju vendosim në grupin e “admiruesve të brisqeve” nëse shohim se blini shpesh brisqe në internet ose mund të jeni një “blerës i pazareve” nëse vëmë re se përdorni kuponë në internet ose kërkoni zbritje ose oferta. Mund t'i deduktojmë këto gjëra rreth jush bazuar në aktivitetin tuaj në faqe të caktuara internet, lidhjet që klikoni

në faqet tona të internetit dhe faqet e tjera të internetit që vizitoni, aplikacionet celulare që përdorni ose emailt e markës sonë që shihni dhe lidhjet që klikoni në email, si dhe bazuar në mbi informacione të tjera që kemi mbledhur, si p.sh. nga dyqane partnere dhe palë të tjera të treta. Grupojmë së bashku cookie dhe identifikues të pajisjeve për të na ndihmuar që të mësojmë rreth prirjeve, zakoneve ose karakteristikave të përgjithshme nga një grup konsumatorësh që veprojnë të gjithë në mënyrë të ngjashme në internet dhe/ose jashtë tij. Duke e bërë këtë, mund të gjejmë dhe t'u shërbejmë shumë të tjerëve që "duken si" ata tashmë në grup dhe prandaj u dërgojmë atyre ato që besojmë se do të jenë oferta dhe informacion të përshtatshme dhe të dobishme.

### **Lidhim informacione të tjera me skedarët e tuaj të personalizimit dhe ID e pajisjes:**

ID e skedarët e personalizimit dhe të pajisjes suaj mund të plotësohen me informacione të tjera, si p.sh. informacione për produktet që blini jashtë interneti ose informacione që na jepni drejtpërdrejt kur krijoni një llogari në faqet tona të internetit. Përgjithësisht e bëjmë këtë në mënyrë që nuk ju identifikojnë direkt personalisht juve. Për shembull, mund ta dimë se ID e skedarët e personalizimit ABC12345 i përket grupit të dashamirësve të briskut bazuar në vizitat në faqen e internetit të një personi, moshën, gjininë dhe shprehjet e blerjeve. Nëse duam të identifikojmë personalisht informacionin e skedarit të personalizimit ose të pajisjes suaj (historikun e shikimit në internet dhe në aplikacion), do ta bëjmë këtë në përputhje me ligjet në fuqi.

**Mund t'ju njohim nga kompjuterët, tabletat, telefonat dhe pajisjet tuaja:** Mund të dimë se ID e skedarit të personalizimit ABC12345 është nga një kompjuter që mund të lidhet me të njëjtin person ose familje që zotëron telefonin celular me ID të pajisjes EFG15647. Kjo do të thotë se mund të kërkonte pelena në kompjuterin tuaj portativ, të klikoni në një lidhje të rezultatit të kërkimit në Google që e kemi sponsorizuar dhe më pas të shihni një reklamë për pelenat e markës sonë Pampers® në telefonin tuaj celular. Mund të supozojmë ose të nxjerrim përfundimin se i njëjti person zotëron kompjuterin dhe telefonin sepse, për shembull, hyn nga i njëjti rrjet Wi-Fi çdo ditë në të njëjtën kohë. Të kuptuarit se cilat pajisje duket se përdoren nga një person ose familje na ndihmon të kufizojmë numrin e herëve që shihni të njëjtën reklamë në pajisjet tuaja. Dhe kjo është e rëndësishme sepse në atë mënyrë nuk mërziteni me ne se ju dërguam në mënyrë të padëshirueshme të njëjtën reklamë dhe nuk paguajmë për reklama të tilla të përsëritura që nuk duam që ju t'i merrni.

**Media e adresueshme:** Kur na jepni të dhënat tuaja personale nëpërmjet faqeve të internetit ose aplikacioneve tona, ne do të përdorim një enkriptim të atyre të dhënave - ose një identifikues zëvendësues si UID2 i The Trade Desk - për t'ju paraqitur reklama që mendojmë se mund t'ju pëlqejnë. E bëjmë këtë përgjithësisht duke ngarkuar një version të pseudonimizuar (të zëvendësuar me shkronja ose numra artificialë) të adresës suaj të emailit, numrit të telefonit ose ID tuaj të reklamimit celular në një platformë që ofron hapësirë reklamimi (p.sh., Facebook, YouTube, Instagram, TikTok etj.

). Ne i përdorim këto të dhëna për t'ju paraqitur reklama përmes asaj që quhet rrjet i hapur. Kjo do të thotë që mund të shihni reklama përkatëse nga ne në faqe interneti si nytimes.com ose aplikacione ose vende të tjera si televizione dixhitale që marrin pjesë në ankandet në internet të inventarit të reklamave të tyre.

**Përputhja e avancuar:** Disa nga faqet tona të internetit përdorin veçoritë e përputhjes së avancuar të ofruara nga platformat e rrjeteve sociale për reklamuesit e vet (p.sh. [Facebook's Advanced Matching](#), [TikTok's Advanced Matching](#), etj.). Nëpërmjet përputhjes së avancuar, do t'i dërgojmë disa nga të dhënat personale që vendosni në fushat e formularit të faqes sonë (p.sh., emrin, adresën tuaj të emailit dhe numrin e telefonit – jo ndonjë të dhënë delikate apo kategorie të posaçme) në një format të pseudonimizuar në platformën e rrjeteve sociale. ose pikseli i platformës së rrjeteve sociale do të pseudonimizojë dhe do t'i tërheqë ato të dhëna automatikisht, me qëllim që të ndihmojë në lidhjen e skedarit të personalizimit të shfletuesit ose ID e pajisjes. E bëjmë këtë në mënyrë që të mund ta përshtatim dhe matim më mirë efikasitetin e reklamimit tonë në platformat përkatëse të Mediave sociale. Kjo është mënyra sesi mund ta dimë se nëse ju kemi shfaqur një reklamë në një Platformë të caktuar të mediave sociale, keni klikuar mbi të, keni ardhur në faqen tonë dhe keni blerë diçka – ose jo – dhe kështu nëse na duhet të vazhdojmë të blejmë reklama në atë Platformë të mediave sociale – ose jo.

**Karakteristikat e reklamimit të Google Analytics:** Disa nga faqet tona të internetit përdorin [Google Remarketing Lists for Search Ads with Analytics](#) ("RLSA"), që është një shërbim që ua ofrojnë reklamuesve. Kur individët vizitojnë faqet tona, Google Analytics mbledh të dhëna për vizitat e tyre. Nëse një vizitor është identifikuar në llogarinë e tij të Google, jemi në gjendje t'i ofrojmë përdoruesit reklama me bazë interesi, kur kryen një kërkim në Google për termat që lidhen me faqen e internetit të P&G që kanë vizituar. Për shembull, nëse jeni identifikuar në një llogari të Google kur vizitoni faqen tonë të internetit Head & Shoulders, mund t'ju ofrojmë reklama të Head & Shoulders kur kërkoni për "shampo kundër zbokthit" në Google. Aftësia jonë për të përdorur dhe ndarë informacionin e mbledhur nga Google Analytics në lidhje me vizitat tuaja në faqet tona është i kufizuar nga [Kushtet e përdorimit të Google Analytics](#) dhe [Politika e konfidencialitetit e Google](#). Për të kuptuar se si i përdor Google të dhënat kur përdorni faqet e internetit ose aplikacionet e partnerëve tanë, vizitoni [këtu](#). Mund të [çregjistroheni nga Google Analytics](#) në çdo kohë.

## ✓ Teknologji të tjera që mund të përdorim

**Sinjalizues me bazë afërsie:** Sinjalizuesit dërgojnë sinjale njëkahëshe tek aplikacionet celulare që instaloni në telefonin tuaj në distanca shumë të shkurtra për t'ju treguar, për shembull, se cilat produkte janë në shitje ndërsa kaloni nëpër një dyqan. Sinjalizuesit vetëm flasin me pajisjen tuaj kur vini aq afër dhe pasi keni dhënë pëlqim brenda aplikacionit celular që shoqërohet me një sinjalizues të caktuar. Nga ana tjetër,

aplikacionet mund të na sigurojnë informacion të vendndodhjes për të na ndihmuar që të personalizojmë reklamimin dhe ofertat për ju. Për shembull, kur jeni pranë një sinjalizuesi në pjesën e kujdesit për lëkurën të një supermarketi, mund t'ju dërgojmë një kupon për \$4 zbritje.

**Pikselë:** Këto janë elemente të vogla të integruara në një faqe interneti, por nuk janë të dukshme. Ato gjithashtu njihen si "etiketa," "insekte të internetit," ose "gif të pikselëve." Përdorim pikselët për të vendosur cookies në kompjuterin tuaj, për të mbikëqyrur veprimtarinë e faqes tonë në internet, për ta bërë hyrjen në faqet tona më të kollajtë dhe për veprimtari të marketingut në internet. Gjithashtu përfshijmë pikselë në mesazhet tona të emailit promovues ose buletinet për të përcaktuar nëse i hapni dhe klikoni në lidhjet e tyre. Kjo na ndihmon të kuptojmë nëse jeni përdorues aktiv (çka parandalon fshirjen e të dhënave tuaja për shkak të pasivitetit). Kjo na ndihmon dhe të masim efikasitetin e përpjekjeve tona të marketingut dhe të nxjerrim njohuri dhe analiza, që do t'i përdorim për të personalizuar përmbajtjen e komunikimit tonë dhe për të orientuar vendimet tona të marketingut (për shembull, nëse keni hapur një email, por nuk keni klikuar në lidhjet në të, mund të vendosim t'ju riprofilizojmë në Facebook).

**Identifikuesit e pajisjes celulare dhe SDK-të:** Përdorim kod programatik në aplikacionet tona celulare për të mbledhur informacion ndërsa përdorni aplikacionet tona, që është si ato që mbledhin skedarët e personalizimit në faqet tona të internetit. Ky do të jetë informacion si identifikuesit e telefonit tuaj celular (IDFA-të të iOS dhe identifikuesit e marketingut për Android) dhe mënyrën sesi përdorni aplikacionet tona.

**Vendodhja e saktë gjeografike:** Mund të marrim informacione për vendndodhjen tuaj të saktë nga gjëra si p.sh. koordinatat e sistemit të pozicionimit global (GPS) (gjatësia dhe gjerësia gjeografike) kur përdorni aplikacionet tona celulare. Gjithnjë do të merrni një njoftim automatikisht në telefonin ose pajisjen tuaj që ju kërkon të pranoni ose të refuzoni që të na lejoni të dimë saktësisht se ku jeni në botë. Duhet të kuptoni se nuk do t'ju kërkojmë gjithmonë pëlqimin për të ditur përgjithësisht se jeni në një qytet, kod postar, ose provincë më të gjerë. Për shembull, nuk e konsiderojmë të jetë një vendndodhje e saktë nëse gjithçka që dimë është se jeni diku në Manilë, Filipine.

## ✓ Përmbajtja e faqes dhe aplikacionit

**Shtojca:** Faqet tona mund të përfshijnë aplikacione nga ndërmarrje të tjera, si rrjete sociale. Një shembull i një aplikacioni është butoni "Like" i Facebook. Këto aplikacione mund të grumbullojnë informacion (p.sh. URL-në e faqes që vizituar) dhe t'ia dërgojnë atë kompanisë që i krijoi ato. Kjo mund të ndodhë edhe nëse nuk klikoni mbi aplikacionin. Këto aplikacione qeverisen nga praktika e konfidencialitetit dhe afatet e kompanisë që i krijoi ato, edhe pse shfaqen në faqet tona.

**Futjet:** Faqet tona të internetit mund t'ju lejojnë të futeni duke përdorur llogarinë tuaj me një kompani tjetër, si p.sh., "Futja me Facebook". Kur e bëni këtë, do të kemi akses vetëm tek informacioni për të cilin na keni dhënë pëlqimin për të marrë nga cilësimet e llogarisë tuaj në llogarinë e kompanisë tjetër që jeni duke përdorur për t'u futur.

**Përmbajtja e përdoruesit:** Disa nga faqet dhe aplikacionet tona do t'ju lejojnë të vendosni përmbajtjen tuaj për konkurse, blogje, video dhe funksione të tjera. Ju lutemi mbani mend se çdo informacion që jepni ose vendosni bëhet informacion publik. Nuk kemi kontroll sesi të tjerët mund të përdorin përmbajtjen që jepni në faqet dhe aplikacionet tona. Nuk jemi përgjegjës për përdorime të tilla që mund të shkelin këtë praktikë të konfidencialitetit, ligjin ose konfidencialitetin dhe sigurinë tuaj personale.

**Lidhje:**Faqet e P&G mund të përfshijnë lidhje në faqe të tjera, të cilat nuk i kontrollojmë. Ato faqe do të qeverisen nga praktikat dhe kushtet e tyre të konfidencialitetit, jo tonat.

## ✓ Vendimmarrja dhe profilizimi i automatizuar

Vendimmarrja e automatizuar nënkupton marrjen e një vendimi duke përdorur mjete të automatizuara pa përfshirjen e njeriut. Profilizimi është një formë e përpunimit të automatizuar të të dhënave personale që përbëhet nga përdorimi i të dhënave personale për të vlerësuar disa karakteristika personale të një individi me qëllim të analizimit ose parashikimit, për shembull, preferencat personale të atij individi, interesat, sjelljet e mundshme etj.

Siç e keni lexuar në këtë Praktikë të konfidencialitetit, mbledhim një larmi të dhënash personale si nga ju, ashtu edhe nga burime të tjera të disponueshme tregtare. Këto të dhëna kombinohen dhe analizohen, duke përfshirë ndonjëherë përdorimin e algoritmave, për të identifikuar lidhjet midis sjelljeve të caktuara dhe karakteristikave personale. Përdoruesit e P&G që kanë karakteristika të ngjashme ose kanë kryer veprime të ngjashme ka të ngjarë të kenë interesa të ngjashme në produktet tona: bazuar në këtë analizë, krijohen segmente të konsumatorëve të P&G dhe profilizohen sipas rastit me ofertat përkatëse përmes emailit, reklamave në internet dhe rrjeteve sociale.

Ky proces na lejon të personalizojmë komunikimet tona sipas interesave tuaja të deklaruar ose të supozuara. Megjithatë, nuk do të kryejmë asnjë proces të automatizuar vendimmarrjeje, duke përfshirë profilizimin, që mund të prodhojë efekte ligjore ose që mund të ndikojë në mënyrë të ngjashme në mënyrë të konsiderueshme të drejtat dhe liritë tuaja, sipas Nenit 22(1) dhe (4) të GDPR dhe, nëse duam të angazhohemi në praktika më intruzive profilizimi dhe gjurmimi, gjithmonë do t'ju informojmë dhe, aty ku kërkohet ligjërisht, do të kërkojmë pëlqimin tuaj përpara sesa ta bëjmë këtë ose do t'ju ofrojmë të drejtën për t'u çregjistruar.

### ✓ Me pëlqimin tuaj

Kur kemi pëlqimin tuaj, mund t'ua zbulojmë të dhënat tuaja personale të tjerëve, si p.sh. partnerëve të zgjedhur, në mënyrë që t'ju dërgojnë oferta, promocione ose reklama rreth produkteve ose shërbimeve për të cilat besojmë se mund të jeni të interesuar. Për shembull, ata që marrin emaile P&G nga markat tona të pelenave, si Pampers®, mund të pranojnë gjithashtu të mësojnë për qumësht formule për bebe nga kompani të tjera.

### ✓ Platformat në internet dhe kompanitë e teknologjisë së reklamave

Faqet e internetit dhe aplikacionet tona mund të vënë në dispozicion informacionin e kontaktit, identifikuesit unikë, informacionin e supozuar dhe të deduktuar, informacionin nga interneti dhe teknik, dhe të dhënat e vendndodhjes me platformat në internet dhe kompanitë e teknologjisë së reklamave për të na ndihmuar t'ju paraqesim reklamat dhe ofertat përkatëse, në varësi të kërkesave ligjore të zbatueshme, të cilat mund të përfshijnë pëlqimin dhe/ose çregjistrimet. Nuk ua shesim të dhënat tuaja personale tregtarëve jashtë P&G në këmbim të kompensimit monetar. Ju lutemi shihni seksionin Njoftimi i konfidencialitetit për shtete të SH.B.A.-së të praktikës së konfidencialitetit më poshtë për informacion shtesë.

### ✓ Shitës

Mund t'ua zbulojmë ose t'ua vëmë ndryshe në dispozicion të dhënat tuaja personale shitësve tanë (duke përfshirë "ofruesit e shërbimeve" dhe "përpunuesit" të përcaktuar sipas ligjeve në fuqi, të cilëve kolektivisht u referohemi si "**ofrues të shërbimeve**" ose "**shitës**" këtu) të cilët na ndihmojnë të drejtojmë biznesin tonë. Kjo përfshin mbajtjen e faqeve tona, përpunimin e informacionit të pagesave për blerjet e bëra nga ju përmes faqeve tona, dërgimin e emaileve tona dhe komunikimet e marketingut të ju, analizimin e të dhënave që mbledhim, na ndihmojnë me atribuimin e shitjeve (p.sh., për të parë nëse ju kemi shfaqur një reklamë në një faqe platforme dhe më pas keni blerë një produkt nga ne) dhe duke ju dërguar produktet dhe shërbimet që keni kërkuar. Gjithashtu zbulojmë ose ua vëmë në dispozicion të dhënat tuaja personale avokatëve, auditëve, konsulentëve, firmave të teknologjisë së informacionit dhe të sigurisë, dhe të tjerëve që na ofrojnë shërbime. Zbulojmë ose përndryshe vëmë në dispozicion vetëm të dhënat personale të nevojshme që këto kompani të kryejnë detyrat që kërkojmë ose, kur lejohet nga ligji në fuqi, të përdorim të dhënat personale për qëllime të caktuara të brendshme, si siguria ose zbulimi i mashtrimit. I udhëzojmë



ofruesit tanë të shërbimeve që të përpunojnë dhe mbrojnë siç duhet të dhënat tuaja personale.

## ✓ Pagesa për blerje

Pagesat për blerje të bëra përmes disa prej faqeve tona në internet përfundohen duke përdorur një sistem të pagesës në internet të shitësit të palës së tretë. Për këto faqe interneti, P&G nuk ka akses tek informacioni i kartës tuaj të kredisë të dhënë për blerje dhe nuk ruan ose jep informacionin e kartës tuaj të kredisë si pjesë e blerjeve tuaja përmes këtyre sistemeve të palëve të treta. Informacioni personal ose financiar që i jepni sistemit tonë të pagesës në internet në këto faqe interneti, i nënshtrohet politikës së konfidencialitetit e kushteve të përdorimit të palës së tretë dhe rekomandojmë të shqyrtoni këto politika përpara dhënies së ndonjë informacioni personal ose financiar.

## ✓ Arsye ligjore dhe të ngjashme

Nëse një markë ose një nga bizneset tona të cilit i keni dhënë të dhëna personale i shitet një kompanie tjetër, të dhënat tuaja do t'i jepen asaj kompanie. Si rezultat, llogaria juaj dhe të dhënat personale në të nuk do të fshihen përveç nëse i thoni markës së kompanisë së re se dëshironi që të fshihet. Gjithashtu mund t'ia japim informacionin tuaj kompanive që na ndihmojnë të mbrojmë të drejtat dhe pasurinë tonë ose kur kërkohet nga ligji ose autoritetet qeveritare.

---

## Llojet e të dhënave personale që mbledhim

**Si një kompani e madhe, me shumë produkte dhe biznese në shumë vende të botës, mbledhim llojet e mëposhtme të të dhënave personale për t'u shërbyer më së miri konsumatorëve tanë.**

Kini parasysh se kjo është një listë gjithëpërfshirëse e llojeve të ndryshme të të dhënave personale që ne mbledhim dhe se i mbledhim ato vetëm kur kemi një bazë të ligjshme për ta bërë këtë (për shembull kur kemi pëlqimin tuaj ose kur kemi nevojë për këtë informacion për lidhjen e një kontratë në të cilën ju jeni palë ose kur përpunimi është i nevojshëm bazuar në interesin tonë legjitim ose për respektimin e një detyrimi ligjor). Shumë nga këto lloje pothuajse me siguri nuk do të zbatohen për ju. Nëse doni të dini se çfarë të dhënash kemi në të vërtetë për ju, [thjesht pyesni](#).

## ✓ Ajo që mbledhim zakonisht

**Informacioni i kontaktit:** Elementet e të dhënave në këtë kategori përfshijnë emrat (duke përfshirë pseudonimet dhe emrat e mëparshëm), titujt, adresën e postës,

adresën e emailit, numrin e telefonit/celularin dhe informacionin e kontaktit për personat përkatës (si p.sh. përdoruesit e autorizuar të llogarisë suaj).

**Demografia dhe psikografia e përgjithshme:** Elementet e të dhënave në këtë kategori përfshijnë karakteristikat dhe preferencat personale, si p.sh. mosha, statusi martesor dhe familjar, përkatësia racore dhe etnike (për shembull, në lidhje me informacionin që jepni në lidhje me blerjet ose preferencat tuaja për kujdesin e flokëve ose të lëkurës), preferencat e blerjeve, gjuhët të dhënat e programit të folur, besnikërinë dhe shpërblimet, të dhënat demografike të familjes, të dhënat nga platformat e rrjeteve sociale, informacioni arsimor dhe profesional, hobit dhe interesat, dhe rezultatet paraprirëse nga palët e treta (mundësia e blerjes, përjetimi i një ngjarjeje të jetës etj.).

**Informacioni për transaksionet dhe i natyrës tregtare:** Elementë të të dhënave në këtë kategori përfshijnë informacion të llogarisë së konsumatorit, të dhëna të kualifikimit, historia e blerjes dhe regjistra që kanë lidhje (kthimet, regjistra të shërbimit të produktit, regjistra të pagesave, kredive, etj.), regjistra lidhur me shkarkimet dhe blerjet e produkteve dhe aplikacioneve, të dhëna jo-biometrike të mbledhura për autentifikimin e konsumatorit (fjalëkalime, pyetje të sigurisë së llogarisë), regjistra të shërbimit për konsumatorin.

